



# **KRITERET PËR NJERËZOREN**

(Marrë nga libri *Diskutime Spirituale*)

*Diskutimet e Shehid Murtezā Mutahharūt*

Më është kërkuar të diskutoj çështjen e kriterëve të njerëzores. Nëse do duhej ta bënim këtë nga këndvështrimi i biologjisë, kjo do të ishte një punë e lehtë meqë do të kishim të bënim me trupin e njeriut dhe vendin e qenieve njerëzore në botën shtazore, me ç'rast nuk ka dallime ndërmjet individëve. Sipas standardeve të anatomisë, mjekësisë e madje të, deri në njëfarë shkalle, edhe psikologjisë, nuk ekzistojnë ndryshime thelbësore ndërmjet dy a më tepër individëve.

Por a është njerëzorja e kufizuar te trupi? A është përkryeshmëria dhe fisnikëria njerëzore e burgosur tek pamja fizike e njeriut? Në shkencat humane flitet për njeriun e përkryer dhe atë të papërkryer, e llojit të ulët dhe të lartësuar. Ç'tip qenieje njerëzore është i denjë për t'u respektuar etikisht e shoqërisht për këtë apo atë përsosmëri, apo meritues i përçmimit për mospërsosmëritë e tija apo të saja? Kjo është një temë që ka tërhequr gjithmonë vëmendjen, jo vetëm në dijen njerëzore, por edhe në fetë e ndryshme. P.sh., Kur'ani flet për qenie njerëzore që janë më të lartësuar se ëngjëjt dhe të denja për nderim nga këta. Ai gjithashtu përmend qenie njerëzore të cilat janë inferiore ndaj shtazëve.

Cilat janë atëherë kriteret që masin dallimet ndërmjet qenieve njerëzore? Kjo pyetje nuk është e lidhur vetëm me fenë. Filosofët materialistë, gjithashtu, që nuk besojnë në Zot dhe religjion, e diskutojnë çështjen e njeriut, njerëzimit dhe qenieve superiore e inferiore.

Cilat janë kriteret sipas këtyre filosofëve? A mund të themi së njerëzit janë të barabartë gjenetikisht, por ndryshojnë në dije? Kjo si diçka që fitohet dhe jo që trashëgohet, në mënyrë që një person me më shumë dije është më i lartësuar se një që ka më pak? A është e lidhur kjo me dijen akademike që e cakton përparësinë në lidhje me nivelin dhe shkallën e njohurive të dikujt? A i respektojmë ne njerëzit në përpjestim me dijet e tyre? A është Ebu Dheri i nderuar sepse ishte më i ditur së bashkëkohësit e tij? A është Muavia i papëlqyer dhe qortim-meritues pse kishte njohuri inferiore?!

Unë nuk besoj se dija është kriter për njerëzishmërinë. Po të ishte ashtu, do të na duhej të thonim se Einsteini ishte më i dhuntisuri me veti të njerëzishme, ngaqë ishte njeriu më i ditur i kohës së vet.

Një pikëpamje tjetër është ajo që, edhe pse dija përbën një nga domosdoshmëritë e njerëzimit dhe megjithëse rëndësia e ndërgjegjes, shoqërisë dhe botës nuk mund të mohohet, ajo është e pamjaftueshme. Ky gjykim pohon se njerëzishmëria matet nga karakteri dhe prirja. Një person mund të jetë shumë i ditur, por nëse ai ka një karakter të keq, a do konsiderohej si një qenie më të vërtetë njerëzore?

Një kafshë sillet në përputhje me instinktet e veta dhe nuk zotëron vullnet që të sundojë mbi to. Kur ne e quajmë një qen kafshë besnike, besnikëria e tij është instinktive. Një milingonë është e kujdesshme për nga instinkti. Ka gjithashtu edhe qenie njerëzore në botë të cilat kanë prirje që i ngjan asaj të një kafshe. Ata zotërojnë instinktet e tyre natyrore, por nuk kanë bërë asgjë që ta përmirësojnë vetveten dhe janë të dënuar të ndjekin vetëm natyrën e tyre.

Vetëdija e kafshës është e kufizuar brenda hapësirës dhe kohës së saj, ndërkohë që vetëdija e njeriut i lejon atij të njohë të kaluarën dhe të ketë një ide mbi të ardhmen, dhe gjithashtu të kapërcejë zonën e madje edhe planetin ku jeton. Por çështja e karakterit është një gjë tjetër. Dija lidhet me atë që i mësohet dikujt, ndërsa karakteri ka të bëjë me të edukuarit dhe të formuarit e shprehive.

Nuk mendoj se dija është e pranueshme si kriter për njerëzoren dhe do e shpjegoj më vonë se kush e mbështet atë. Këndvështrimi i dytë, d.m.th, (që) vetitë (të merren) si kriter për të njerëzishmen, ka më shumë mbështetës. Por ne mund të pyesim - cilat lloje vetish dhe

prirjesh? Një nga përgjigjet e kësaj pyetjeje është se dashuria përbën kriterin e dëshiruar; dashuria, e cila është nëna e të gjitha prirjeve të tjera të holla. Kështu, nëse dikush e themelon karakterin e vet mbi dashurinë e qenieve njerëzore, atëherë ai ka njerzishmëri të vërtetë. Një person i tillë është po aq i interesuar në 'veten' e të tjerëve sa edhe në të tijën, madje edhe më shumë se në të tijën.

Në fe kjo quhet vetë-sakrificim. Ekziston një pohim në një libër, se të gjitha fetë e kanë udhëzimin e dashjes për të tjerët të asaj që do për vetveten, dhe mospëlqimit për ta të asaj që nuk pëlqen për veten. Kjo është pohuar (me kohë) në traditat tona. Kjo është logjika e dashurisë. Siç dimë, në shkollat e Hinduizmit dhe Kristianizmit, vihet theks i madh mbi dashurinë. Por ata kanë shkuar aq larg sa të humbin nga sytë gjithçka tjetër dhe të pohojnë që dashuria duhet të jetë drejtuesja e (vetme e) të vepruarit në të gjitha rrethanat. Kështu, dashuria e këtyre dy ideologjive është një lloj habie e madhe dhe përshtatshmëria e dashurisë si një kriter për njerëzoren duhet të diskutohet.

Por nëse pranojmë si kriter dashurinë për qeniet e tjera njerëzore, çështja do të zgjidhet më lehtë po të pranojmë dijen si kriterin kryesor. P.sh., në lidhje me preferencën tonë për Ebu Dherin mbi Muavijen, ne jemi në pozicion më të mirë t'i gjykojmë ata në bazë të dashurisë. Muavija ishte një njeri egoist dhe ambicioz që shfrytëzonte të tjerët me forcë. Ebu Dheri ishte e kundërta dhe megjithëse ai kishte të gjitha mundësitë dhe madje Muavija ishte i gatshëm t'i ofronte shumë privilegje, prapëseprapë ai shqetësohej për fatin e të tjerëve sidomos të shtypurve nga Muavija. Ja pse ai u ngrit kundër këtij njeriu të lig dhe i harxhoi vitet e fundit të jetës në arrati, ku edhe vdiq. Kështu, ne e quajmë Ebu Dherin njerëzor ngaqë ai i donte të tjerët dhe ne e konsiderojmë Muavijen të panjerzishëm sepse ai ishte i interesuar vetëm tek vetja.

Po kështu, përse mendojmë ne se Hazreti Aliu është një qenie njerëzore e përkryer? Sepse ai ndjente dhimbjen e tërë shoqërisë dhe 'Uni' i tij ishte bërë 'Ne'. Personaliteti i tij i tërhiqte të gjithë. Ai nuk ishte një individ i ndarë nga të tjerët. Ai ishte një gjymtyr apo organ i një trupi të tërë. Ai vetë thonte se dhimbja në një pjesë të shoqërisë, po ashtu si në trup, bënte të ndjehej edhe në pjesët e tjera, njëra prej të cilave ishte edhe ai vetë. Aliu e deklaroi këtë shumë më parë se filozofia humaniste e shekullit të 20të ta pretendonte atë si një ideal.

Kur dëgjoi se një pushtetar i caktuar nga ai kishte marrë pjesë në një festim, ai i shkroi një letër qortimi, e cila citohet në *Nexhul-Belaga*. Nuk përmendet se ç'lloj festimi kish qenë, nëse kishte patur pirje, kumar apo kërcim. Sundimtari që konsideruar si fajtor nga Hazreti Aliu sepse ai kishte marrë pjesë në një festim aristokratik që nuk ishte ndjekur nga asnjë i varfër.

Ai thotë, "Kurrë nuk besoja se një pushtetar dhe përfaqësues i imi do ndjekte një mbrëmje të tillë të fisnikëve." Ai pastaj përshkruan vetë jetën e tij dhe thotë që ai e ndjeu dhimbjen e të tjerëve më shumë se të tijën dhe se dhimbja e tyre e pengoi së ndjeri të tijën. Fjalët e tij tregojnë ai ishte një i mençur më të vërtetë i dijshtëm e i urtë. Prapëseprapë, arsyeja pse ne e ndërojmë kaq thellësisht atë nuk është dituria e të gjerë, por sepse ai ishte i njerzishëm. Ai nuk i ishte i pandërgjegjshëm ndaj fatit të të tjerëve.

Një shkollë tjetër mendimi konsideron vendosmërinë dhe fuqinë e vullnetit si kriter për njerzishmërinë. Ajo pohon se nëse një person mund të sundojë vetveten dhe instinktët e tija, zemërimin dhe pasionet nëpërmjet fuqisë së vullnetit dhe arsyes së vet, e nuk mbizotërohet nga prirjet dhe dëshirat e tij, ai është me të vërtetë njerëzor.

Ka një ndryshim ndërmjet dëshirës dhe vullnetit. Dëshira është një tërheqje nga një forcë e jashtme, një marrëdhënie midis njeriut dhe objekteve të jashtme, si një njeri i uritur i tërhequr nga ushqimi, apo tërheqja seksuale. Edhe gjumi madje është një tërheqje. Po kështu është dëshira për rang dhe pushtet. Por vendosmëria është diçka e brendshme, që e liron njeriun nga

shtytja e dëshirës. Ajo i vendos dëshirat nën zotërimin e fuqisë së vullnetit për t'i përdorur ato (ashtu) siç i sheh të përshtatshme. Shumica e moralistëve tanë të së kaluarës e theksonin vullnetin si një kriter për njerëzimin. Njerëzit, në ndryshim nga kafshët, që sundohen nga instinkti, mund të vendosin të veprojnë kundër prirjeve të tyre. Kështu, një person i vendosur është me human se një që nuk mund të kontrollojë 'egon' (*nefs-in*) e tij.

Një kriter tjetër për njerëzshmërinë është liria. Çfarë do të thotë kjo? Ajo do të thotë se në atë shkallë që një njeri nuk toleron asnjë forcë dhe nuk nënshtrohet nga cilido pushtet dhe mund të zgjedhë lirshëm, në atë shkallë është njerëzor ai. A është ky vështrim i saktë apo jo? Është edhe i saktë edhe i pasaktë. Si domosdoshmëri për njerëzoren, është i saktë, por si kriteri i vetëm për njerëzoren, është i gabuar.

Islami ka vënë theks të madh mbi vetë-përmbajtjen. Po përmend një histori këtu që lidhet me këtë. Shkruhet se Profeti (s) po kalonte pranë një vendi në Medine ku një numër të rinjsh po vinin në provë fuqinë e tyre duke ngritur një gur të rëndë. Kur panë Profetin (s), ata e lutën të shërbente si gjyqtar. Profeti (s) pranoi dhe në fund të garës ai tha, "A e dini cili është më i forti? Është ai që e përmban zemërimin e tij dhe nuk e lejon veten të mposhtet nga ai. Ai s'duhet ta përdorë zemërimin e tij në një mënyrë të kundërt më dëshirën e Zotit dhe duhet të jetë i aftë të sundojë mbi ndjenjat e tija."

Atë ditë, Profeti (s) ktheu një garë fizike në një spirituale. Ajo që ai nënkuptonte ishte se fuqia fizike tregonte burrëri, por se nuk ishte shenja e vetme e saj. Burrëria e vërtetë është në fuqinë e vullnetit.

Ne e quajmë Hazreti Aliun 'Luani i Allahut', sepse ai është më burrëror se të gjithë, në dy mënyra: Jashtë në shoqëri e në mejdan ku ai mundi të mposhtë kundërshtarët më të fortë; dhe, më e rëndësishme se kjo, përbrenda - në kuptimin që ai ishte në kontroll të përkryer të vetvetes dhe të çdo dëshire dhe teke.

Xhelaluddin Rumi tregon një ngjarje në 'Methnevin' e tij për Hazreti Aliun si një të ri 24 apo 25 vjeçar ku ai portretizon një pamje të hollë burrërie. Ai e kishte hedhur përtokë kundërshtarin e tij në një betejë e ishte ulur mbi gjoksin e tij, gati për ta vvarë. Njeriu pështyn në fytyrën e Hazretit. I bezdisur, Hazreti Aliu e lë përkohësisht njeriun dhe ecën përrotull për ca çaste. Njeriu e pyet pse e la në dorë të vet. Hazreti përgjigjet, "Nëse do të të kisha vvarë, do të kishte qenë në zemërim e sipër e jo në mënyrën e detyrës sime në rrugën e Allahut." Ky është një shembull i mrekullueshëm vetë-përmbajtjeje.

Hazreti Aliu thotë në testamentin e tij të birit, Imam Hasanit, "Konsideroje veten dhe jetën tënde përmbi çdo vepër të ulët. Për ato që jep nga jeta jote për hir të dëshirave, nuk shpërblehesh me asgjë. Mos e bëj veten skllav të të tjerëve, sepse Zoti të ka krijuar të lirë." Çështja e lirisë është diçka që shkolla e ekzistencializmit gjithashtu e pranon si kriter për njerëzshmërinë.

Një kriter tjetër për njerëzinë është çështja e detyrës dhe përgjegjësisë e cila filloi me Kantin e që është theksuar në kohën tonë. Kjo d.t.th ndjenja e përgjegjësisë ndaj shoqërisë, vetes dhe familjes. Si duhet të arrihet kjo ndjenjë dhe cila është baza e saj? A krijohet ajo në ndërgjegjën e njeriut?

Një tjetër shkollë mendimi, duke përfshirë platonizmin, konsideron bukurinë si kriter për njerëzoren. Të gjitha shkollët e njohin dhe e aprovojnë drejtësinë. Njëra e aprovon drejtësinë nga pikëpamja etike. Një tjetër ngaqë konsideron se ka një marrëdhënie midis drejtësisë dhe lirisë, ndërsa Platoni mendon së drejtësia është e mirë në të dyja - shoqërinë dhe individin, sepse çon në barazpeshë dhe bukuri. Sigurisht, ideja e tij e së bukurës është padyshim bukuria shpirtërore.

Në një rast tjetër do t'i krahasojmë të gjitha këto shkolla dhe do të përmbledhim vështrimet e Islamit mbi këtë çështje.

---

Ligjërata e dytë

## SHKOLLA E HUMANIZMIT

Tema e diskutimit tonë është 'shkolla e njerëzimit' (humanizmit). Qenia njerëzore që është qenia e vetme kureshtare në botën që njohim, i është nënshtruar gjithmonë shqyrtimit hetues dhe diskutimit.

Fjala 'njerëzi' (humanizëm) është lidhur gjithmonë me një ndjenjë krenarie dhe shenjtërie si një qenie superiore ndaj kafshëve nga mjaft këndvështrime si p.sh. dija, drejtësia, liria, ndërgjegjia morale, etj. Ndonëse shumë nga objektet e shenjta të njerëzimit i janë nënshtruar dyshimit dhe madje mohimit, mesaduket asnjë shkollë mendimi nuk ka shkuar aq larg sa të përbuzë dinjitetin e veçantë të njerëzimit dhe superioritetin e tij mbi krijesat e tjera.

Ky fakt është shprehur në mënyrë elegante në poemat e Rumiut dhe Sa'diut si dhe nga poetë tanë të tjerë. Kjo pikë është gjithashtu tema e pjesës më të madhe të letërsisë botërore, fetare dhe jo-fetare, në të cilat është përshkruar çështja e njerëzimit dhe madhështimi i tij. Në literaturën islame gjithashtu, në persisht dhe arabisht, në ndeshemi me shumë pohime të tilla.

Në dy shekujt e fundit, me zhvillimin e shkencës, njerëzimi ka rënë papritur nga ai pedestal i shenjtërisë që i ishte dhënë ngaherë. Ai ra me një rrënim të vërtetë sepse sa më e lartë është ngritja, aq më i madh është dëmi i shkaktuar nga rënia. Në të kaluarën, njerëzimi që ngritur në qiell deri në rangun e një demi-zoti siç dëshmohet në poemat e Hafizit dhe poetëve të tjerë.

Zbulimi i parë (i madh) i njerëzimit ishte struktura e universit, që i revolucionarizoi idetë e tij. Para kësaj, toka besohej të ishte qendra e gjithësisë, përreth së cilës silleshin të gjitha planetet dhe yjet. Shkenca vërtetoi se toka ishte një planet i vogël që sillej rreth diellit dhe sistemi diellor ishte vetëm një pjesë e parëndësishme e universit.

Pikërisht atëherë pozicioni i njerëzimit si qendra e të gjitha mundësive dhe si qëllimi i krijimit iu nënshtrua dyshimit dhe mohimit, e askush nuk guxoi të shprehej për pozicionin e tij të lartësuar. Atëherë, një tjetër goditje që u dha, ishte ideja se qenia njerëzore nuk ishte më një krijesë hyjnore dhe (idea e) mëkëmbësit të Zotit në tokë u braktis.

Kërkimet biologjike në fushën e evolucionit dhe origjinën e specieve njëherësh treguan lidhjen e njerëzve me po ato kafshë që ata kishin përbuzur dhe përçmuar. Ajo i nxorri ata si të evoluuar nga një lloj majmuni apo ndonjë kafshë tjetër e kështu ata humbën prejardhjen e tyre hyjnore.

Një tjetër goditje e fuqishme kjo kundër listës në pamje të parë të shkëlqyer të veçorive të njeriut - e pikërisht asaj që ai mund të vepronte në atë mënyrë që tregonte vetëm mirësi dhe dhembshuri, motivi i vetëm i të cilit ishte dashuria e Zotit dhe që i mungonin të gjitha aspektet shtazarake. Kjo tezë e re shtronte se këmbëngulja e njerëzimit në të gjithë shenjtërinë dhe virtytin ishte e rrëmë dhe të gjitha virtyteve të cilave u ishte dhënë emri i dashurisë për dijen, artin, bukurinë, moralin e ndërgjegjen, lutjen dhe përkushtimin si dhe gjithçka metafizike, janë të ngjashme me ato që mund të gjenden gjithashtu edhe te kafshët, vetëm se në një formë dhe mekanizëm më të ndërlikuar. Disa shkuan deri aty sa të pohonin se stomaku ishte qendra

e mendimeve dhe ndjenjave të tija. Kishte të tjerë që madje e konsideronin këtë pozicion shumë të lartë dhe pohonin se qenia njerëzore ishte edhe më e ulët se kaq.

Përfundimisht u arrit në konkluzionin se kjo qenie që më përpara kishte pretenduar prejardhje hyjnore dhe lartësim duhej t'i nënshtrohej një hulumtimi të kujdesshëm për të zbuluar natyrën e tij. Një tjetër teori e ofruar ishte se nuk ka ndryshim midis njerezve, bimëve dhe madje objekteve pa jetë. Ëkziston, sigurisht, ndryshimi në ndërthurje dhe formë, por jo në lëndën nga e cila ishin të përbëra të gjitha. U pohua se shpirti dhe fryma hyjnore ishin të paqenë sepse njeriu është një mekanizëm që s'është gjë tjetër veçse pakëz më e ndërlikuar se mekanizmat e tjera si makinat, aeroplanët dhe satelitët; pra, vetëm një krijesë mekanike.

Kjo ishte një goditje e rëndë ndaj njerëzimit dhe prapëseprapë vlerat njerëzore nuk u shpallën plotësisht të pavlefshme, përveçse në disa shkolla mendimi ku ide si paqja, liria, spiritualiteti, drejtësia dhe dhembshuria e mëshira konsideroheshin si shaka'.

Mirëpo, që nga fundi i shekullit të 19të, njerëzimi ka rifituar një vëmendje të freskët në shkollat e filozofisë si ajo e humanizmit dhe madje adhurimit të qenieve njerëzore. Në të kaluarën, qenia njerëzore ishte vetëm një simbol spiritualiteti dhe Kur'an'i flet për qeniet njerëzore si krijesa më me vlerë nëpërmjet së cilës mund të kuptohej Zoti.

Tani njeriu po përpiket ta ripërtërijë dinjitetin dhe shenjtërinë e tij të mëparshme dhe të bëhet një qëllim në vetvete por pa zbatimin e kritereve të mëparshme dhe pa marrë parasysh dimensionin e tij hyjnor apo jo-hyjnor, apo pikat e shtruara në Kur'an se çdo gjë e krijuar në tokë është për të dhe se Zoti ka fryrë një pjesë të Shpirtit të Tij tek ai duke e bërë një manifestim të Tijin.

Nuk kanë mbetur më aspak fjalë për çështjet e mësipërme e madje as një diskutim i motiveve të brendshme njerëzore, por vetëm të besuarit në shenjtërinë e njerëzimit dhe intelektin e tij. Tani po i shohim të gjitha shkollat e mendimit, madje edhe deklaratën e të drejtave të njeriut t'i fillojnë pohimet e tyre me respekt për dinjitetin si karakteristikë thelbësore të qenieve njerëzore. Ata e pohojnë këtë për ta bazuar edukimin mbi themelet e saj, dhe paçka se çdo individ është i aftë të dhunojë të drejtat e të tjerëve, ky respekt për dinjitetin dhe shenjtërinë e njeriut do të shërbejë si kontrollues për shkelje të tilla.

Shumica e atyre që ndjekin filozofinë e humanitarizmit, kanë kritere të ndryshme nga ato të së kaluarës. Por, vështirësia qëndron në të njëjtën kontradiktë të jetës, mendimit dhe logjikës së njerëzimit sot, një logjikë së cilës i mungon themeli.

Nuk mendoj se ka ndonjë dijetar në botë që do ta interpretonte humanitarizmin si të njëjtë me paqen universale. Ekzistojnë, natyrisht, persona të zakonshëm që mendojnë së të gjitha qeniet njerëzore në botë janë të njëjtë dhe të një vlerë të barabartë. Por kjo nuk është e vërtetë. Njëri është i ditur, tjetri është injorant; njëri është i virtutshëm, tjetri është i përlyer; njëri është dashamir, tjetri është keqdashës. A duhet t'i konsiderojmë të gjithë ata të njëjtë nga këndvështrimi i njerzishmërisë, pavarësisht nga dija, besimi, nderi dhe dashamirësia e tyre apo anasjelltas?

Nëse mendojmë kështu, ne tradhetojmë njerëzimin. Më lejoni të jap një shembull. Të dy, A dhe B, janë qenie njerëzore që janë biologjikisht të ngjashme. Nëse juve s'ju pëlqen njëri prej tyre, kjo s'ka të bëjë aspak me grupin e tij të gjakut. Por nëse jeni humanist, ju s'mund të qëndroni indiferent përballë të dyve dhe të pohoni se ata janë njëllor të njerëzishëm; sepse atëherë të dy duhet të pëlqehen njëllor apo të dy të mospëlqehen njëllor. Por kjo nuk është kështu ngaqë ndryshimi thelbësor i njeriut me kafshët është se qenia njerëzore ka më shumë potenciale dhe më pak instikt se kafshët. Ç'do të thotë kjo? Një kalë në lindjen e tij zotëron të gjitha veçoritë që duhet të ketë një kalë dhe nëse ka më pak se aq, mund t'i fitojë më praktikë. Por një qenie njerëzore ka potencial vetëm në lindje. Nuk dihet se çfarë do bëhet ai apo ajo në

të ardhmen. Forma e jashtme është njerëzore por ai person mundet në të vërtetë të bëhet një ujk, një dele, apo një qenie njerëzore.

Mullā Sadrā, filosofi i madh islam nga Irani, duke theksuar gabimin e njerëzve në të menduarit se të gjitha krijesat njerëzore janë të njëlojtë në gjithçka, tregon se ka aq lloje individësh sa edhe vetë individë. Ai, natyrisht, flet për qenien njerëzore filosofikisht, jo biologjikisht. Një biolog i kushton vëmendje organeve dhe gjymtyrëve të njeriut, ndërkohë që një filosof përqendrohet në cilësitë e njeriut dhe kështu ai s'mund të besojë se qeniet njerëzore janë të gjitha të njëlojta. Ja pse vlerat njerëzore janë potenciale. Disa arrijnë lartësinë e njerzishmërisë, e të tjerë dështojnë ta bëjnë këtë. Sic thotë Hazreti Aliu, "Trajta (pamja e jashtme) është njerëzore, por mendja mund të jetë pre bishe." Jo të gjithë individët kanë një botë të brendshme përpjestimore (përputhësë) me paraqitjen.

Siç e kam thënë më parë, në një masë të madhe, bota rrotullohet, edhe një herë te shkolla e humanizmit, duke nënkuptuar që filosofi të humanizmit janë shfaqur; dhe më e çuditshma ndër të gjitha është kredoja e humanizmit që krijoi Auguste Comte nga mesi i shekullit të 19të. Ky njeri lëkundej mes intëligjencës dhe mendjes së tij nga njëra anë, dhe zemrës e ndërgjegjës së tij në tjetrën, dhe arriti në përfundimin se njeriut i nevojitej besimi, mungesa e të cilit sjell të gjitha llojet e korrupsionit shoqëror. Sipas tij, feja e së kaluarës (Katolicizmi) nuk është e përshtatshme për njerëzimin modern. Ai përshkruan tre stade të fesë: Stadin hyjnor të mbinatyreshëm, stadin e arsytimit filosofik dhe stadin shkencor pozitivist. Ai thotë se Katolicizmi i përkiste të menduarit të mbinatyreshëm të qenies njerëzore dhe se kjo është e papranueshme për njeriun e epokës moderne. Mirëpo, fesë së tij të shpikur, i mungonte rrënja okultiste, por ai pranoi të gjitha traditat dhe ritet që ekzistonin më parë e madje propozoi klerikë të lartë në këtë besim të ri, duke e paraqitur veten si profet i tij, por një profet pa Zot. Thonë për të se i huazoi ritet nga Katolicizmi dhe për këtë u kritikua meqenëse ai s'e besonte atë fe, por imitoi dhe përshtati ceremonitë dhe ritualet e saj. Ai kishte të drejtë në një gjë, që qenieve njerëzore u nevojitet adhurimi dhe përkushtimi si dhe kryerja e një numri ritesh.

Ai mesaduket gjeti një numër të madh përkrahësish në Evropë e Amerikë dhe shtëpia e tij ishte bërë qendër pilgrimimi për ta. Sipas disa librave, ai kishte rënë në dashuri me një zonjë burri i së cilës qe dënuar më burgim të përjetshëm, por ajo vdiq përpara se ai t'ia fitonte zemrën dhe si pasojë ai bëri kthesë nga bota e intelektit drejt botës së ndjenjave dhe përfundimisht filloi kredon e tij tek njerëzimi. Kjo zonjë dashurie mbahet nga pasuesit e tij e shenjtë sa Maria, e ëma e Isait (pqmt). Por kjo shkollë humanizmi pësoi një numër ndryshimesh që i dhanë asaj formën e tanishme.

Një ndër pyetjet që kanë të bëjnë me qenien njerëzore është liria dhe përgjegjësia. A është qenia njerëzore me të vërtetë e lirë apo ka një përgjegjësi dhe mision për të kryer? Sipas Kur'anit, njeriu nuk vihet përballë asnjë imponimi përpara Zotit. Përkundrazi, njeriu është i krijuar i lirë me një përgjegjësi dhe mision të përcaktuar. Kur'ani Fisnik i referohet qenies njerëzore si 'mëkëmbësi i Zotit', ndërkohë që asnjë libër hyjnor nuk ia ka dhënë një shenjtëri të tillë njeriut. Zoti thotë në Kur'an, "Dhe kur Zoti i juaj i tha ëngjëjve, Unë po vendos në tokë një mëkëmbës, ata u përgjigjën, Çfarë do vendosësh atje, një që do bëjë poshtërsi dhe derdhi gjak... Por Zoti u përgjigj, Padyshim, Unë di atë që ju nuk dini."

E gjithë kjo është dëshmi e talenteve dhe potencialeve të njeriut. Ju, pra, e shihni se Islami, që është një shkollë humanizmi, beson në pozicionin e lartësuar të qenies njerëzore nga pikëpamja filosofike. Kur'ani thotë përsëri se Zoti i mësoi njeriut emrat e të gjitha gjërave. Pastaj e paraqiti atë superior ndaj ëngjëjvë në këtë dituri dhe Zoti i qortoi ëngjëjt për atë që nuk dinin për njerëzinë dhe duke e kujtuar njeriun për një krijesë të tërbuar dhe të epshme, ata kishin mospërfillur anën tjetër të karakterit të tij. Ëngjëjt e pranuan paditurinë e tyre dhe u lutën për falje nga Ai. Pastaj Zoti i tha ëngjëjve t'i përuleshin krijesës së Tij.

Interpretimi më i mirë që mund t'i bëhet këtij urdhri me qëllim që të tregojë misionin e njeriut, lirinë dhe mundësinë e zgjedhjes, është se Zoti e bën atë të deleguarin dhe mëkëmbësin e Tij. Zoti është Krijuesi e këtu Ai i dhuron njeriut një pjesë të fuqisë së Tij krijuese që të përfitojë prej saj.

Një tjetër çështje për qenien njerëzore është lumturia dhe kënaqësia e tij. Po e përmënd shkurtimisht se njeriu kërkon kënaqësi. Ku duhet të gjehet ajo? A është nga përbrenda apo nga përjashta, apo nga të dyja dhe në ç'raport? Ata që e përqendrojnë vëmendjen mbi kënaqësitë jashtë tyre, duke menduar gabimisht se ky është i gjithë gëzimi i jetës, nuk kanë arritur ta njohin vetveten si qenie njerëzore. Ata nuk kanë mundur ta konsiderojnë jetën përbrenda tyre si burim lumturie dhe kënaqësie. Gjallërimi i tyre qëndron në një gotë verë, një kabare. Sa bukur e përshkruan Rumi një person të mvarur nga pija dhe e drejton një person të tillë nga rruga e drejtë dhe larg së keqes duke i thënë,

*Ti je simboli i ekzistencës, përse atëherë  
kërkon shkatërrim?  
Ti je një oqean, ç'ke ndërmend të  
bëhesh?  
Përse ia jep veten  
hua verës?*

Ai vazhdon duke thënë se njeriu është esenca dhe se bota është forma.

Është po aq e gabuar të mohohen të gjitha gjërat e jashtme dhe të shkohet në skajin tjetër e të menduarit se të gjitha gëzimet duhet të kërkohen përbrenda. Në disa poema të Rumiut ndeshemi me një teprim të tillë kur ai thotë,

*Kij parasysht se rruga për te kënaqësia është  
e tëra nga brenda, jo nga jashtë  
Dhe quaje të budallepsur braktisjen e  
zakoneve dhe traditave.  
Dikush është i lumtur dhe i trullosur  
tek e një burgut qoshe e tij,  
E një tjetër është plotësisht i brengosur  
tek i bukuri kopësht i tij.*

Ai me këtë nuk nënkupton se të gjitha gjërat e jashtme duhen lënë mënjanë por, në të njëjtën kohë, nuk duhet menduar se të gjitha gëzimet gjehen në gjërat materiale. Vetja është qendra e lumturisë dhe duhet të këtë një barazpeshë midis së brëndshmës dhe të jashtëmës.

Ka shumë gjëra për të thënë mbi njeriun. Shkolla e mendimit që e konsideron veten humane, duhet të jetë e aftë t'i përgjigjet disa pyetjeve me qëllim që të pranohet si një shkollë me të vërtetë humane. Njeriu u konsiderua si porta e spiritualitetit, d.m.th vepra spirituale mund të zbulohet nëpërmjet vetë thelbit të tij si qenie. Spiritualiteti dhe humanizmi apo feja dhe humanizmi, janë dy çështje të pandashme. Ne nuk mund të pranojmë njërin dhe të braktisim tjetrin. Kundërshtia që ne mendojmë se ekziston në shkollët e ndryshme vërtet humaniste qëndron në atë që kur njerëzimi pësoi një rënie, sado gabueshëm, d.m.th përmes një ndryshimi në astronominë e Ptolemeut, kjo s'duhet të na bëjë të dyshojmë në pozicionin e lartësuar të qenies njerëzore si një qëllim në vazhden e krijimit. Njeriu është qëllimi i gjithësisë, qoftë toka qendër e universit apo jo. Ç'do të thotë fraza 'qëllim i krijimit'? Do të thotë se natyra lëviz në një drejtim të caktuar në vazhden e saj evoluese qoftë nëse e konsiderojmë qenien njerëzore të krijuar spontanisht apo (qoftë nëse e konsiderojmë) një



vazhdim të tjera specieve shtazore. Nuk ka dallim për këtë proces nëse ne e mendojmë atë të zotërojë një shpirt hyjnor apo jo.

Zoti ka thënë. "Ne frymë në të (një pjesë) nga shpirti Ynë." Ai nuk ka thënë se qeniet njerëzore janë raca e Zotit. Sikur të kishte thënë se lënda nga e cila përbëhet njeriu u soll nga një botë tjetër, atëherë ai do të ishte një qenie e lartë dhe e shenjtë.

Atyre prej jush filozofia e të cilëve është humanizmi, ne ju themi, a ka ndonjë ndjenjë në qenien e njeriut të quajtur dhembshuri, mirësi ose sakrificim, apo jo? Nëse ju thoni se nuk ka, atëherë t'ia mvishni një cilësi të tillë njeriut do të ishte aq e pakuptimtë sa ta quanim atë një copë gur apo kafshë. Por njeriu e ka ndjenjën. Ç'është ajo? Dikush mund të thotë që ndjenja e shërbimit brenda nesh është një lloj zëvendësimi. Ç'do të thotë kjo? Kur ne dëshmojmë diçka dhe ndjenja jonë njerëzore ngrihet për të ndërhyrë dhe këshilluar, shërbyer dhe shpëtuar të shtypurit, na thuhet që nëse e peshojmë mirë këtë, ne si qenie njerëzore e vëmë veten në vendin e tyre, duke menduar për ta së pari si pjesëtarë të grupit tonë ose si të grupit tonë të lidhur me ta, dhe më pas ne e zëvendësojmë veten me ta. Atëherë, ndjenja e egoizmit që na bën të mbrojmë veten, lind për të mbrojtur të shtypurit; përndryshe nuk ka asnjë ndjenjë të natyrshme në qenien (njerëzore) për të mbrojtur drejtpërdrejt një person të shtypur.

Shkolla e njerëzores duhet së pari t'i përgjigjet asaj se nëse ekziston një ndjenjë e tillë tek njeriu apo jo? Ne i përgjigjemi se ajo ekziston duke u bazuar në caktimin e tij si mëkëmbës i Zotit dhe si shpalosje të bujarisë dhe mëshirës hyjnore. Kjo do të thotë se ndërkohë që njeriu në egoizmin e tij është i detyruar të tregojë gjallëri për të mbijetuar, esenca e ekzistencës së tij nuk është egoizmi. Njeriu ka gjithashtu butësi, njerëzi, botëkuptim dhe ndërgjegje morale.

Ca kohë më parë ku isha në Shiraz, më prezantuan një shoqatë të quajtur Organizata e Lumtur, e cila përbëhej nga individë me një ndjenjë të brendshme e besnikëri personale dhe një grumbullim i të shurdhërve dhe memecëve. Unë vizitova një orë të tyre. Për ne njerëzit e lehtë-bezdisshëm do të ishte stërmunduese të kalonim vetëm një orë në një klasë të tillë dhe t'i vështronim ata dhe veprimet e tyre të çuditshme sa për vërejtje. Mësuesi i tyre ishte një Sejjid që quhej me emrin e djalit të parë të Imamit dhe i cili po tregonte interes dhe simpati të madhe për ata fëmijë edhe pse rroga e tij ishte më e vogël se ajo e një mësuesi të shkollës fillore, sepse ajo organizatë qëndronte dobët me të ardhurat. Ai i kish mësuar atyre të shkruanin dhe të kuptonin fjalët nëpërmjet një përpjekjeje të madhe.

Ç'është kjo ndjenjë tek njeriu? Ajo është manifestimi i njerzishmërisë dhe natyrës së tij. Në përgjithësi, ç'është kjo ndjenjë lëvdimi (miratimi) të së mirës dhe mospëlqimi të së keqes, edhe pse ato i përkasin të së kaluarës? Kur ne dëgjojmë emrat e Jazidit dhe Shimrit dhe kujtojmë tmerret dhe krimet e tyre, e nga ana tjetër, kur përmenden emrat e martirëve të Qerbelasë ne fitojmë një ndjenjë urrejtjeje për grupin e parë dhe çudie e respekti për të dytin. Cila është arsyeja për këtë? A është ajo një ndjenjë ithtarizmi (asabijje) që na bën ta mendojmë veten si pjesëtarë të grupit të martirëve të Qerbelasë dhe mospëlqejmë Jazidin, Shimrin dhe armiq të tanë? Apo mos ndoshta ne i projektojmë ndjenjat tona të simpatisë (bashkëvuajtjes) dhe urrejtjes mbi secilin grup përkatësisht, ndërkohë që në të vërtetë të dy janë të lidhur me ne? Nëse është kështu, atëherë personi që e konsideroni armikun tuaj nuk do jetë aspak ndrysh nga ju. Sepse nga ana e tij ai ka të drejtë të lëvdojë ata që ju urreni dhe të urrejë ata që ju lëvdoni.

Përkundrazi, ju mund ta shikoni këtë nga një këndvështrim tjetër që nuk është personal dhe individual por që ka të bëjë me tërë njerëzimin e ku nuk bëhet fjalë për mospëlqim personal, por për të vërtetën. Këtu, identifikimi që bëni me martirët në lëvdimin tuaj, dhe mospëlqimin e armiqve të tyre, nuk është personale, por e përgjithshme dhe universale.

Shkolla e humanizmit duhet t'i japë përgjigje asaj se ç'janë këto ndjenja dhe nga ngrihen ato, dhe problemeve të tilla si dashuria e sinqertë e njeriut për mirënjohjen ndaj dikujt që ka bërë një vepër të mirë. Kur zbulohet natyrshmëria e vlerave njerëzore, atëherë del në sipërfaqe çështja e qenies njerëzore. A është qenia njerëzore e bekuar me cilësi të tilla, e njëjtë me atë të përfolur nga materializmi? A është ai person një makineri, një satelit? Një makineri, sado e madhe, është vetëm e madhe; nëse ndërtohet një makineri njëmijë herë më e madhe se një Apollo, ç'mund të thuhet për të? Mund të themi se është e madhe, e mahnitshme dhe e jashtëzakonshme, por jo fisnike dhe e shenjtë. Edhe nëse ndërtohet një miliard herë më e madhe, duke pasur një miliard pjesëza, prapëseprapë ajo mund të quhet vetëm e mahnitshme dhe e jashtëzakonshme por kurrë fisnike, e shenjtë apo e nderueshme. Si mundën deklarata e të drejtave të njeriut dhe filosofët komunistë që e mbështesin natyrshmërinë njerëzore në mënyra të ndryshme, të flasin për shenjtërinë dhe prestigjin e brendshëm që zotëron njeriu, pa i kushtuar vëmendje fjalëve të Zotit "Ne kemi fryrë një pjesë të Shpirtit Tonë në të". Kur të konstatojnë natyrshmërinë e këtyre vlerave, atëherë ata do mund të kuptojnë natyrshmërinë e vetë njeriut.

Tani, duke supozuar se e dallojmë këtë natyrshmëri të qenies njerëzore (pyesim) - a është vetëm njeriu që ekziston në këtë univers që ndodhet në errësirë të pafund? Siç thotë një Evropian, a është qenia njerëzore vetëm një pikë djerse në një oqean helmi të krijuar rastësisht? Apo njeriu është një pikë uji të ëmbël në një oqean të ëmbël? Kjo dritë e vogël a përfaqëson dritë universale?

Këtu lidhja e natyrshmërisë (thelbit) të qenies njerëzore me Zotin do të bëhet e qartë, sepse ato të dyja janë të pandashme. Në formulimin e Kur'anit Fisnik, Zoti është drita e qiejve dhe e tokës, ku fjala Zot nuk është ajo që Aristoteli quan Shkakun e Parë, sepse kjo është e ndryshme me Zotin e Islamit. Zoti i tij është i ndarë nga dhe i huaj ndaj gjithësisë. Por Zoti i Islamit, kur dëgjohet fraza 'Ai është i Pari, Ai është i Fundit, Ai është e Jashtëmja dhe Ai është e Brendshmjja' (57:3), të jep menjëherë një vështrim tjetër mbi universin. Atëherë ju arrini të kuptoni të gjitha cilësitë thelbësore brenda vetes tuaj dhe dalloni që ka një qëllim. Ju do shikoni që nëse ju jeni një rreze drite atëherë një botë e tërë dritë ekziston dhe nëse ju jeni një pikë uji të ëmbël, kjo ndodh ngaqë një oqean i tërë i pafund ëmbëlsie ekziston përpara jush dhe një rreze nga drita e Tij ndodhet brenda jush.

Islami është një shkollë humaniste e bazuar në kritere humane. Nuk ka asgjë në të të bazuar në diskriminime të gabuara midis qenieve njerëzore. Në Islam nuk ekziston vend, racë, gjak, krahinë dhe gjuhë. Këto gjëra nuk janë një dëshmi apo kriter privilegji për qeniet njerëzore. Këto kriter në Islam e përbëjnë këto vlera njerëzore. Nëse (Islami) i respekton ato vlera, kjo ndodh ngaqë beson në natyrshmërinë e thelbit të njeriut dhe gjithësisë; dmth beson në Zotin e Plotfuqishëm. Ja përse Islami është e vëtmja shkollë humaniste që ka për themel logjikën e vërtetë dhe shkolla të tjera si kjo nuk ekzistojnë në botë.

Shqipëroi: Edin Q. Lohja,  
Prill 2000